




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së shtatë - VII - të, të rregullt të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 04.08.2021, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Ilir Hasani, Jetmir Berisha, Sabit Bullatovci, Miranda Shabani, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Mensur Graiçevci, Hysni Hasani, Suhat Ademi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Mungon: Albert Jasharaj.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Afrim Krasniqi - Drejtor i Administratës, Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, Jakup Tërnavë - Drejtor i Gjeodezisë Kadastrit dhe Pronës dhe Besnik Hykolli - Udhëheqës i Drejtorisë së Inspektoratit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 08.06.2021.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë.
4. Propozim për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Apollonisë në Fushë-Kosovë.
5. Propozim për lejimin e normave të reja për punëtorë në arsim.
6. Propozim për dhënien në shfrytëzim të automjetit zyrtar për Statcionin e Policisë në Fushë-Kosovë.
7. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe hapi diskutimin.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Thëksoi se pikat tre dhe katër të rendit të ditës, nuk janë në kompetencën e Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendosje, por Kryesuesja

e Kuvendit të Komunës është duke vepruar, nën urdhërat e Kryetarit të Komunës lidhur me pikat për shqyrtim në Kuvend. Muaji gusht është muaj i pushimeve për Kuvendin, kurse mbledhja po mbahet tani për arsye se ndonjë anëtarë i Kuvendit të Komunës, ka qenë në pushime, ju e nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës jeni duke e shkelur Rregulloren e Punës dhe çdo gjë sipas rregullave të shkruara, po veproni në mënyrë të gabuar.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Theksoi se dispozitat e nenit 3 dhe 4 i Udhëzimit Administrativ 2008/10 për emërtimin e shkollave e definon qartë, se pikat tre dhe katër të rendit të ditës, nuk janë në kompetencën e Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendosje. Propozimi për emërtimin e shkollave vjen nga baza, fillon në Këshillin e Shkollës, por ju po bëni politikë këtu, ne jemi për shkolla të reja, edhe në mënyrë unanime e kemi votuar 'Propozimin për themelimin e dy institucioneve parauniversitare në komunën tonë', por ju po bëni lojëra të tilla dhe kjo punë nuk është në rregull kështu.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Theksoi se nuk pajtohet me vlerësimet që janë bërë nga Organizata Jo Qeveritare, lidhur me punën dhe angazhimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, kjo organizatë e ka monitoruar Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës, vetëm këtë vitë dhe atë jo në të gjitha mbledhjet, e bënë vlerësimin vetëm për gjashtë muaj, në fund të mandatit zgjedhor, duke anashkaluar angazhimin tonë për 48 muaj dhe paraqet një lloj inflacioni të padrejtë në raport me publikun, realitetit të nderuarë kolegë është krejt ndryshe, vlerësimi nuk është i plotë, duket sikur të jetë i porositur, këto organizata që na monitorojnë duhet të identifikohen.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Theksoi se kam dëgjuar për këtë vlerësim të Organizatës Jo Qeveritare, por të jeni të sigurtë se ky opinion nuk ndikon në përkrahjen e secilit prej juve. Vendimet e Kuvendit të Komunës dërgohen për vlerësim në Ministrinë respektive, ju nuk keni nevojë të bëni vlerësime paraprake.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Secili anëtarë i Kuvendit të Komunës e dinë angazhimin dhe punën e tij, vlerësimi mund të mos jetë i duhuri, meqë nuk përfshinë një periudhë të gjatë kohore, është vlerësim vetëm për disa muaj.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. E nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës dhe të nderuarë kolegë, unë do t'i them dy fjali në emër të Partisë së Drejtësisë të cilën e përfaqësoi në Kuvendin e Komunës, sepse kohën e fundit në opinion, kanë filluar të qarkullojnë fjalë dhe etiketime lidhur me punën tonë dhe kjo punë nuk është në rregull unë këta persona do t'i ndjekë edhe penalisht dhe siç po duket do të detyrohemi të ngritim një padi, sepse po linçohemi pa të drejtë nga disa individë, unë jam imam në fshatin Miradi e Epërme dhe bëjë punën time, angazhohemi me njerëzit për rregullimin e ambientit dhe punë tjera të përbashkëta, të njohura për banorët. Tjetra është duke u bërë shumë zhurmë në lokalet që janë edhe afër Stacionit të Policisë, duhet të mirren masa konkrete. Lidhur me emërtimin e shkollave ju pa të drejtë, po na vendosni neve në pozitë të vështirë. Propozimi për emërtimin e shkollës në lagjen e Dardanisë, me emrin e Akademik Idriz Ajeti, ku ne duhet të vendosim, unë e kam sqaruar qëndrimin tim në mbledhjen e kaluar. Kjo punë e ka rrjedhën e vetë, që e cakton qartë Udhëzimi Administrativ, edhe pse kjo punë dihet se është formale, por duhet të përmbushet, respektoni rregullat, mos veproni pa kritere.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës së propozuar për këtë mbledhje.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', dhjetë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 08.06.2021.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 08.06.2021, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim për diskutimet tuaja.

Pasi që diskutime tjera nuk pati lidhur me përmbajtjen e ekstraktit të procesverbalit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 08.06.2021.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', dhjetë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 08.06.2021.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrijnë pyetjet e tyre për Ekzekutivin e Komunës.

Durim Hajra: Tani rruga 'Naser Sekiraga' është duke u ndërtuar nga zeroja, me ndriçim publik, por ju e dini se ne para dy viteve, e kemi marrë një vendim në Kuvendin e Komunës për kompenzimin e një pronari atje, ju atëherë në arsyetimin tuaj keni theksuar se duhet të hiqen disa mure, për drejtimin e rrugës, andaj duhet të bëhet ky kompenzim. Tani, ne pyesim a ka shpronësime tjera të pronarëve aty, apo pronat kanë qenë të uzurpuara. Vendosija e shtegut për këmbësorë në rrugën kryesore në Fushë-Kosovë, nuk është bërë si duhet dhe paraqet rrezik për qytetarët që kalojnë aty, duhet të bëhet një sinjalizim më i mirë, shënimi i vijave të bardha dhe të vendosen edhe shenja tjera paralajmëruese për automjetet. Nga Drejtoria e Inspektoratit kërkojmë që të ndërhyjnë, në ndalimin e zhurmës nëpër lokale afariste, që po organizojnë ndeja në lagjen e Dardanisë, orari i punës nuk po respektohet, po punohet edhe pas orës 22:00h. Ndriçimi publik nuk po funksionon në rrugët 'Hashim Hajdini', 'Imer Prizreni' dhe 'Ramë Bogujevci', njësoi ka defekte edhe te pishat, ne e dimë që ka një kontratë kornizë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, duhet të rregullohen kjo punë, meqë tani vijnë edhe mërgimtarët dhe fluksi i qarkullimit të njerëzve është mi i madh.

Mehdi Lahu: Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam disa çështje që dua t'i ngriti tani, për Drejtorinë e Inspektoratit, pse nuk po intervenoni kur po vendosen pa kriterë kiosqe, në

trotuarin e rrugës tek Çerdhja e Fëmijëve afër Stacionit të autobusëve dhe po krijojnë shumë pengesa, për qytetarët që e presin autobusin, të nderuarë aty njerëzit janë duke e marrë hapësirën në shfrytëzim dhe ato kiosqe janë duke u lëshuar me qira, aty puna nuk është duke u bërë nga njerëzit nevojtarë dhe pronarët, por nga njerëzit që po përfitojnë. Banorët e fshatrave: Bardh i Madh, Graboc i Poshtëm dhe fshatrave tjera, kanë problem me sigurimin e ujit të pishëm, meqë çeshmja e KEK-ut për një kohë nuk ka funksionuar, unë kam takuar njerëz nga fshati Bardh i Madh duke marrë ujë në lagjen e Lakrishtës në Prishtinë, ne propozojmë që komuna të angazhohet për vendosjen e disa çeshmeve në vendet publike, për furnizimin e qytetarëve me ujë. Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit e kam një pyetje, pse nuk po sanohen rrugët që prehen nga Kompanitë e ndryshme publike, pas kryerjes së punimeve? Po ashtu, shtegu për ciklistë nuk është punuar sipas standardeve të caktuara, që nga vendosja e vendeve për kalimin e këmbësorëve në rrugën kryesore, te objekti 'Mehana' kanë ndodhur katër aksidente, duhet të mirren masa konkrete dhe shpejtë, këtu jemi në qytet, duhet të bëhet kufizimi i shpejtësisë në 40km në orë, nga lagjja e Bresjes deri te rruga për Uglarë. E fundit lidhur me sondazhin, vlerësimin e Organizatës Jo Qeveritare për punën e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, duhet t'ia ndalojmë kësaj organizate monitorimin e punës së Kuvendit, meqë vlerësimi i tyre nuk është real, kërkoi falje nga kolegu z. Ilir Hasani, por unë mendoi se kam qenë më aktiv, kjo organizatë nuk ka të drejtë ta dezinformon opinionin publik.

Mirvete Gërguri: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Uji nuk është ndalur nga KEK-u, ka patur një prishje e cila ka zgjatur një kohë, pastaj pas intervenimit është rregulluar nga Kompania e Ujësjetës Rajonal Prishtina.

Migjen Kolshi: Kjo organizatë e ka huqur plotësisht, edhe lidhur me identifikimin tonë, mua më identifikon si pjesë e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ndërsa unë jam në kuadër të Iniciativës Qytetare të Fushë-Kosovës, po thuaj se nga fillimi i mandatit, këta janë të painformuar.

Driton Ademi: Përfaqësuesit e organizatave listat i marrin në Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk i identifikojnë personat që lëvizin për përfitime personale gjatë mandatit.

Migjen Kolshi: Nuk ka nevojë ta personalizojmë këtë punë, ne kemi ngritur shumë shqetësime si përfaqësues të opozitë, por edhe disa anëtarë nga pozita kanë qenë aktiv në paraqitjen e problemeve dhe shqetësimeve të qytetarëve, vlerësimi është jo real dhe i pa arsyeshëm, andaj unë kërkoi që të hidhet në votim, përjashtimi i kësaj organizate nga monitorimi i punës së Kuvendit të Komunës. Unë e kam një pyetje, për Nënkryetarin e Komunës dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, fjala ka qenë për rrugën në lagjen 'Rrafshinat' duhet të intervenohet, pastaj rruga për të shkuar tek shtëpia e Nuhi Hykollit, aty është një tmerr i vërtetë, për fshatin Harilaç nuk është duke u punuar sa duhet, nuk janë rrethuar as varrezat, po ashtu për mirëmbajtjen e rrugëve e keni një kompani, por disa intervenime në raste të caktuara, mund të bëhen edhe me mjete financiare nga 'paty cash' dhe ju këtë punë e dini mirë, por nuk po veproni. Lidhur me ndarjen e bursave për studentë, pyes pse nuk i është ndarë bursa studentit Lorik Kolshi që e ka notën mesatare 10, edhe nëse ka shumë kërkesa ata që i plotësojnë kriteret e shpalljes publike duhet të përkrahen.

Eglantina Azemi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. E kemi një kërkesë nga banorët e lagjes 'Rrafshinat' të Sllatinës së Madhe që të rregullohet drenazhimi, sepse ata kanë shumë probleme me rrjetin e kanalizimit. Keqëqeverisja në komunën tonë ka degraduar shumë dhe kjo shihet qartë, te mirëmbajtja e parkut të vetëm të qytetit në oborrin e shkollës 'Selman Riza', ku gjindet edhe shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, aty ka shumë mbeturina, madje edhe të lëngshme, por menaxhmenti i komunës ka shfajsimë për secilën çështje, duke thënë se heqja e mbeturinave është punë e Kompanisë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi'. Shumë rrugë në fshatra janë të uzurpuara, pse nuk po vepron për lirim të tyre, pse nuk po mirren masa konkrete, nga Drejtoria e Inspektoratit për lirim të hapësirave publike për qytetarë.

Ilir Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit lidhur me përhapjen e zjarreve, po ashtu, pyes pse nuk po aktivizohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi si trup kompetentë, për të ndihmuar në këtë drejtim, sepse po dëmtohet edhe natyra dhe mjedis i pastër në zona të caktuara nga zjarret, këtu duhet që veprimet të jenë të shpejta në kohë.

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë pajtohem me sugjerimin dhe vlerësimin që e dha kolegu z. Driton Ademi për këtë organizatë, unë nuk kam qenë aktiv në vitin 2021, në tre muajt e fundit, edhe për arsye shëndetësore, sepse kam qenë i prekur me Covid - 19, por unë në tre vitet paraprake kam ngritur shumë kërkesa dhe shqetësime të qytetarëve për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, por mos u lodhni kotë, sepse vlerësimet e tyre nuk ndikojnë në zgjedhje, vetë zgjedhësit tanë do ta vlerësojnë drejtë punën tonë në secilin mjedis.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë dua të ndërlihem me disa tema që u ngritën si shqetësime për qytetarë, njerëzit kanë ende probleme me rrjetin e ujësjellësit, furnizimin me ujë të pishëm, mirëmbajtjen e rrjeteve të kanalizimeve, prerjen e asfaltimve, mos sanimin e gjendjes, duhet të vendoset së paku një shënjë, se është e lejuar të prehet rruga nga organi kompetentë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, e jo të veprohet në këtë formë, sikur këtu mund të veprohet në anarki të plotë, secili bënë punën e vetë kur i duhet, edhe pa leje përkatëse të organeve shtetërore. Po thuaj se 90% e infrastrukturës nëntokësore po bëhet pa plan, pas asfaltimit të rrugëve, këto punë duhet të bëhen me plane. Lidhur me vlerësimet e Organizatës Jo Qeveritare që u theksuan nga kolegët paraprakisht, ata nuk kanë fajë, ne kemi fajë vetë, që nuk kemi qenë sa duhet të angazhuar në publikimin e punës tonë dhe qëndrimeve të shprehura në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, qëndrimet tona dokumentohen në procesverbale, por mungon audioincizimi i mbledhjeve për publikun e gjerë qytetarët në kohën e duhur, ne është dashur të gjejmë rrugë tjera alternative, meqë pushteti aktual nuk e ka respektuar dhe zbatuar 'ligjin dhe rregulloren e punës', mbledhjet kanë vazhduar dhe tani jemi në fund të mandatit, ku menaxhmenti i komunës tonë vetë, e ka vendosur një terrë informativë, në këtë kohë të funksionimit të internetit dhe platëformave të shumta sociale, për informimin e drejtë të qytetarëve.

Driton Ademi: Unë tani dua të ngriti çështjen e njëjtë me kolegun z. Ilir Hasani, lidhur me dukurinë e përhapjes së zjarreve, me djegjen e hamulloreve nëpër arat tona pas të korrurave të grurit, këtu duhet ta kemi një plan të veprimit për intervenim, tani sektori për emergjencë duhet të

jetë shumë aktiv në teren, të vëzhgon situatën, sepse shumë zjarre tani shkaktohen nga faktori njeri, ndoshta ndonjëherë edhe nga pakujdesia e tyre.

Doruntina Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kërkojmë intervenimin e Drejtorisë së Inspektoratit, lidhur me hudhjen e mbeturinave në oborrin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Sllatinë e Madhe në pronën publike. Kontejnerët janë të vendosur në vende jo adekuate në rrugën kryesore 'Nënë Tereza' dhe në lagjen e Dardanisë, ku ka shumë pengesa edhe për lëvizjen e qytetarëve, kërkojmë që të ndërmerren masa për lëvizjen e tyre në vende të caktuara dhe me plan.

Ali Ismaili: Unë e kam një pyetje, lidhur me procesin e legalizimit të objekteve pa leje, më intereson të dijë, deri ku ka arritur ky proces në Komunën e Kushë-Kosovës. Si është e mundur që njerëzit e prekur me kancer të ndihmohen, vetëm më shumën e mjeteve financiare prej: 250.00€, të vijnë dhjetë herë në komunë dhe të mos u transferohen mjetet financiare, këto raste janë të kushtueshme, njerëzit kanë shumë probleme, andaj duhet të veproni me përgjegjësi për këto raste. Për ndarjen e bursave për studentë, kemi informata se ka lëshime, pse nuk e publikoni këtë listë për t'i hequr të gjitha dyshimet tona. Unë kam marrë edhe emaile lidhur me qëndrimin tim për vendime të caktuara, që janë publike, po më dërgojnë edhe selame Nënkrjetar i Komunës, kjo punë kështu është e keqe, vendimet në interesin e përgjithshëm të qytetarëve, unë gjithmonë i kam përkrahur.

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne duhet të jemi të shqetësuar kur nuk zgjidhen çështjet e caktuara për interesin e qytetarëve, i nderuari Nënkrjetar i Komunës, jo për vlerësimet e Organizatave Jo Qeveritare, të rren kush don si të donë, për mua e rëndësishme është adresimi dhe zgjidhja e punës së caktuar, tani banorët e fshatrave: Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme dhe Vragoli janë duke vuajtur, nga rrjeti i kanalizimit që vjen nga lagjia Marigona, që gjindet në Komunën e Graçanicës, duhet të jetë një projekt konkret për zgjidhjen e këtij problemi, i kordinuar me komunën fqinje në këtë rastë, e jo pasojat të barten në territorin tonë. KEDS-i tani neve po na dëmton shumë shtatë fshatra tonat dhe Fushë-Kosovën, me ndërpreje të vazhdueshme të rrymës, kërkoi që për këtë çështje të komunikoni me ta dhe ta zgjidhni. Nga hudhja e mbeturinave inerte, jemi duke pësuar, pse nuk po vepron Drejtoria e Inspektoratit, në fshatin tim. Lumi Graçanka duhet të pastrohet, të rregullohet shtrati i lumit, në mënyrë që të mos ketë vërshime të mëdha. Edhe ndriçimi publik nuk është duke funksionuar për tre javë rreshtë, të intervenohet dhe rregullohet kjo punë.

Sabri Rexhepi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me vlerësimin e Organizatës Jo Qeveritare, ne në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, mbledhemi para mbledhjes së Kuvendit, i adresojmë dhe paraqesim secili çështjet e caktuara, të cilat i parashtrajmë për zgjidhje në Kuvendin e Komunës, në emër të Grupit Parlamentarë. Unë jam anëtarë i Kuvendit të Komunës në pesë mandate, kjo mënyrë e punës tonë si duket është një mangësi, tani dua ta parashtroi për zgjidhje një problem në rrugën e Dardanisë lidhur me kontejnerët e mbeturinave, aty janë të vendosur gjashtë kontejnerë, të cilët mirren nga Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' me rregull, por secili po kërkon që kontejnerët të mos vendosen afër banesave të tyre, unë mendoj, se ata duhet të vendosen në pika të caktuara, e jo sipas njerëzve të caktuar.

Jetmir Berisha: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Të nderuarë kolegë Organizatat Jo Qeveritare nuk janë duke e vlerësuar punën në teren, puna tonë e dinë qytetarët dhe kjo nuk duhet të na brengosë neve fare. Ne i kemi të incizuara shumë probleme në teren, edhe çeshmet, edhe hudhjen e mbeturinave në vende të ndryshme, nuk duhet të shërbehemi me propagandë, lagjja Berisha ka patur një kohë problem me ujin, por ne punojmë dhe i zgjidhim problemet, për ata edhe jemi të thirur, secili në bazë të përgjegjësisë tona institucionale. Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' e bënë marrjen e mbeturinave me rregull, por ne nuk mund të marrim mbeturinat inerte që hudhen nga Kompanitë e ndryshme, aty duhet të vepron Inspektorati dhe Policia e Kosovës. Nuk kemi pajisje për marrjen e mbeturinave të lëngshme, duhet të jemi më të përgjegjës në adresimin e çështjeve. Në lagjen e Dardanisë, është bërë edhe larja e rrugëve.

Ali Ismaili: Kontejnerët nëpër rrugë të caktuara duhet të vendosen, sipas një plani paraprakë të përgatitur dhe dakorduar nga përgjegjësitë, e jo të ketë ndryshime herë pas herë, ndoshta edhe pa ndonjë arsye.

Jetmir Berisha: Ne e kemi një plan me GIZ-in gjerman, për vendosjen e shtëpizave të hekurta në qytet për hudhjen e mbeturinave dhe bashkëpunimi me Drejtorinë e Inspektoratit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, do të na lehtësonte shumë punën.

Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Rruga 'Naser Sekiraga', me kadastër është tetë metra, aty janë hequr disa mure nga banorët, shpronësime dhe kompensim të pronave nuk ka, tani aty do të ndërtohet një rrugë më e gjerë, me standarde dhe me ndriçim publikë. Pynëkryesi nuk ka punuar ditëve të vikendit dhe dikush ndoshta, mund ta ketë shfrytëzuar kohën për vendosjen e rrjetit të kanalizimit pa leje.

Nënkryetari i Komunës: Rruga aty është duke u zgjeruar dhe shpronësime nuk ka në atë zonë.

Durim Hajra: Atëherë pse është kompensuar një pronarë në vitin 2018, ju në këtë mënyrë e keni një vendim në dobi të uzurpatorit dhe e keni dëmtuar vetën, pra paranë publike.

Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Unë e njoh mirë atë zonë, jetoi që gjashtëdhjetë vite aty, ka patur gjithë telashe për kalimin e rrugës nga automjetet dhe këmbësorët afër Hekurudhës, tani është mirë për qytetarët, që po ndërtohet një rrugë me standarde, sepse ka qenë shumë e ngushtë, ka patur disa mure që janë hequr nga qytetarët aty për zgjerimin e rrugës.

Nënkryetari i Komunës: Aty ka qenë një rrugë e vjetër dhe e ngushtë, tani po bëhet një rrugë sipas kritereve dhe me standarde.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me vendkalimet në rrugën 'Nënë Tereza', aty janë të vendosura vijat e bardha, do të bëhet edhe një aneks-kontratë e re dhe do të vendoset sinjalistika e plotë horizontale dhe vertikale. Për ndriçimin publik është e vërtetë, kemi patur probleme me kompaninë për mirëmbajtjen e tij dhe në tre muajt e fundit, ka patur disa defekte, të cilat i kemi evidentuar dhe do t'i rregullojmë. Edhe ne jemi vendosur në situatë të palakmueshme, sepse nuk kemi mundur ta kryejmë punën tonë, për mbeturinat, ne i kemi vendosur tridhjetë e nëntë pika statike, janë demoluara kontejnerët në rrugën 'Hajrullah Zymi', 'Xhemajl Mustafa' dhe 'Shefki Kuleta', ku është dashur të intervenon edhe policia. Ne duhet ta gjejmë një zgjidhje për bunkerizimin e kontejnerëve në vende të caktuara.

Lidhur me çështjet e ngritura nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi për fshatin Harilaç, ne kemi intervenuar disa herë për sanimin e gjendjes dhe këtë e dimë ne që jetojmë aty.

Nënkryetari i Komunës: Rrethimi i varrezave në fshatin Harilaç do të realizohet, për bursat do të shikojmë, për rastet që i dimë dhe janë ngritur dhe nëse ata që i kanë plotësuar kriteret do të ndihmohen, por ju duhet ta dini faktin se këtë vitë, kemi patur shumë aplikues dhe buxheti ka qenë i limituar. Qytetarët me sëmundje të rënda shëndetësore duhet të ndihmohen edhe nga Qeveria e Kosovës. Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje, është në vazhdim e sipër, kemi bërë shpallje dhe apele publike për aplikim, por numri i aplikimeve nuk është i madh. Ndriçimi publikë ndonjëherë mund të jetë jo funksional, por kemi shumë intervenime, e kemi një kompani jo të përgjegjshme, secili dëmtim që mund ta hetojmë, duhet ta adresojmë në Policinë e Kosovës.

Eglantina Azemi: Tani pas njëzet viteve janë vendosur dritat në rrugën 'Xhevë Lladrovci' në Fushë-Kosovë, por aty mungojnë disa kapak në pajisje, të cilët kërkojmë që të vendosen.

Sabit Bullatovci: Në fshatin tim janë marrë mbi pesëdhjetë hektarë tokë banorëve në vitin 2005, ata janë kompensuar më vonë në fshatin Miradi e Epërme, problem im është se janë uzurpuar hyrje/daljet të rrugëve të fshatit, pyes pse nuk ka asnjë intervenim të shtetit për lirin dhe zgjerimin e hapësirave të rrugëve?

Durim Hajra: Ata që i kanë hequr muret për zgjerimin e rrugës, a janë kompenzuar nga komuna jonë.

Nënkryetari i Komunës: Nuk ka kompenzim aty, këtë e theksova edhe më herët në diskutimin tim.

Koha e pushimit prej 10 minutave.

Pika e tretë (3) - Propozim për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Lidhur me 'Propozimin për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë', me emrin e Akademik Idriz Ajeti është shterrur debati në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës, andaj tani ju ftoi që të votoni për propozimin në fjalë.

Migjen Kolshi: Kjo pikë e rendit të ditës nuk është dashur znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, të vendoset për të dytën herë në shqyrtim, sepse nuk është në kompetencën e Kuvendit të Komunës, këtë e kemi sqaruar shumë qartë në mbledhjen e kaluar. Nuk ka nevojë që neve njerëzit të na shajnë, pa kurrfarë nevojë dhe arsye, se gjoja opozita këtu është kundër vendosjes së emrit të shkollës së re, me emërtimin e personalitetit tonë të njohur të ndjerit Akademik Idriz Ajeti dhe ne jemi kundër, kurse pushteti aktual i Lidhjes demokratike të Kosovës është për. Ne kemi kërkuar që këtu të respektohen procedurat dhe propozimi të vjen nga shkolla, por ju këtë po e bëni për poena politike, kërkojmë që ky propozim të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe të zbatohen procedurat. Këtu viktimën tani do ta voton edhe përfaqësuesi i atyre që i kanë kryerë vrasjet dhe ju po shtirrreni sikur nuk kuptoni. Ne kemi edhe shumë propozime tjera të merituar, të dëshmorëve dhe martirëve të komunës tonë për emërtimin e shkollave. Unë po e theksoi këtu me emër se z. Bedri Obërtinca është hajn ordinerë.

Aida Alimi: Vendimi është i jashtëligjshëm, sepse nuk po respektohet procedura e paraparë me Udhëzimin Administrativ, të ndëruarë këtu vendimarrja është arbitrare, ju lutem të mos veproni kështu.

Driton Ademi: Lidhur me këtë çështje të arsimit, duhet ta kemi një kthim prapa në kohë, unë e kam sqaruar se në rastin konkret është në përgjegjësinë e Ekzekutivit të Komunës, krijimi i kushteve për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimorë, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, këtu kemi një kolozion të ligjeve, që në Kosovë është një praktikë e keqe ndeshja dhe kundërthënia e ligjeve, në këtë rast unë e kam sqaruar, se përparësi i jap menaxhimit të arsimit në komunën tonë dhe vota ime është për.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë', me emrin e Akademik Idriz Ajeti.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', një 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë', me emrin e Akademik Idriz Ajeti dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 493, të datës 17.06.2021, për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme e Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë, me emrin e veprimtarit të çështjes kombëtare Akademik Idriz Ajeti.

Pika e katërt (4) - Propozim për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Apollonisë në Fushë-Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës pas sqarimeve e qiti në votim 'Propozimin për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Apollonisë në Fushë-Kosovë', me emrin e arsimtarit të Gjuhës Shqipe dhe veprimtarit të çështjes kombëtare Haki Bajrami.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', një 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Apollonisë në Fushë-Kosovë', me emrin e arsimtarit të Gjuhës Shqipe dhe veprimtarit të çështjes kombëtare Haki Bajrami dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 494, të datës 17.06.2021, për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme e Ulët në lagjen e Apollonisë në Fushë-Kosovë, me emrin e arsimtarit të Gjuhës Shqipe dhe veprimtarit të çështjes kombëtare Haki Bajrami.

Pika e pestë (5) - Propozim për lejimin e normave të reja për punëtorë në arsim.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e normave të reja në arsim për vitin shkollor 2021-2022', ku kërkojmë tridhjetë norma të reja për mësimdhënës dhe dhjetë norma të reja për parafillorë. Kërkesa jonë është që Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ta bënë rritjen e normave të reja në arsim. Hap diskutimin.

Migjen Kolshi: Unë e përkrah propozimin për rritjen e normave në arsim, me mundësi vazhdimi, ju vetë keni thënë se vetëm Ministri i Financave z. Bedri Hamza, i ka lejuar për njëzet vjetë, njëzet norma për arsimin në Komunën e Fushë-Kosovës, por të ndëruarë ato norma janë keqpërdorë dhe janë pranuar dy zyrtarë në komunë në Drejtorinë e Planifikimit Urban, inxhinierë të komunës, njëri është nga fshati Harilaç dhe njëri nga Lipjani.

Remzi Shala: Propozimin për rritjen e normave në arsim, e kemi shqyrtuar dhe analizuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ky propozim është i arsyeshëm dhe është shumë i nevojshëm, për mbarëvajtjen e procesit arsimorë në Komunën e Fushë-Kosovës. Rritja e normave do ta bënte një zgjidhje të përhershme në arsim, ne kemi nevojë për rritjen e numrit të punëtorëve edhe në shëndetësi, ku i kemi vetëm njëqind e katër punëtorë. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për rritjen e normave në arsim për katërdhjetë punëtorë për vitin shkollorë 2021-2022'.

Durim Hajra: Në parim ne jemi për përkrahjen e propozimit në fjalë për rritjen e normave në arsim. Rrjedhat e zhvillimeve në arsim, nuk janë përcjellur në mënyrë adekuate me zhvillimet tjera në komunë, p.sh me ndërtimet në qytet, ne jemi të vetëdijshëm se arsimi ka nevojë për mësimdhënës të ri, por fajet janë të përgjithësuara këtu nga Ekzekutivi i Komunës, nuk duhet të mjaftohemi vetëm me dërgimin e shkresave, por duhet të na njoftoni neve edhe me epilogun e përgjigjeve, e jo vetëm të kërkon miratimin tonë, në momentin e fundit në pragë të fillimit të vitit të ri shkollorë.

Nënkryetari i Komunës: Ne e kemi sqaruar disa herë ndarjen e buxhetit, ne kemi nevojë për shtim të buxhetit në arsim dhe shëndetësi, por këtë punë niveli qendrorë nuk e ka marrë parasysh asnjëherë, edhe duke e ditur seriozitetin e çështjes, përveq Ministrit z. Bedri Hamza, i cili njëherë e ka bërë rritjen e normave në arsim, të cilin e falënderojmë.

Durim Hajra: Nuk duhet të jeni të ashpër këtu, kjo punë nuk zgjidhet vetëm me dërgimin e shkresave në Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Financave. Edhe kjo forma e lidhjes së 'Marrëveshjeve të veçanta' për mësimdhënës gjashtë muaj me mundësi vazhdimi, nuk është e rregulltë dhe nuk është e mbështetur qartë në ligjë dhe as me buxhet, në fund mund të del se është krejtë një zgjidhje puro politike.

Nënkryetari i Komunës: Ju po e shihni dhe e keni para vetës propozimin, aty kërkohet të lejohet shuma e mjeteve financiare prej: 73,468.80€, për marrjen në punë të punëtorëve arsimorë, përmes procedurës së shpalljes publike dhe t'i delegohet kompetenca dhe të autorizohet Kryetari i Komunës, që për muajin shtator dhe tetor të vitit shkollorë 2021/2022 të lidhë 'Marrëveshje të përkohshme të veçanta' për punëtorë arsimorë. Kjo është një zgjidhje e përkohshme, ne edhe në mandatin e kaluar në Kuvendin e Komunës e kemi marrë një vendim, për pagesën e dhjetë arsimtarëve, zgjidhje nuk ka ofruar, as Qeveria e Kryeministrit Avdullah Hoti, as Qeveria e Kryeministrit Ramush Haradinaj, tani është Qeveria e Kryeministrit Albin Kurti dhe presim ta bëjë ndonjë zgjidhje për arsimin, që është zotuar se e ka prioritet, ne nuk bëjmë politikë me nxënës, jemi të detyruar ta gjejmë një zgjidhje, andaj e kemi dorëzuar për shqyrtim një propozim të tillë.

Driton Ademi: Kjo është një zgjidhje e ndërmjetme, nuk është risi forma, ne e dimë ligjin, por si institucione duhet ta gjejmë një zgjidhje, mjetet financiare nuk janë të alokuara, kemi bartur mjete financiare, edhe te Organizatat tjera Jo Qeveritare si është Karitasi. Duhet ta përkrahim alternativën që ofron zgjidhje, përmes shpalljes publike.

Ali Ismaili: Unë kam qenë në Komisionin Komunal për ndarjen dhe sistemimin e nxënësve në shkollë, aty jam propozuar nga përfaqësuesi i komuniteteve, kemi mbajtur takimin e punës, ku prezentë ishte edhe Drejtori i Shkollës 'Mihal Grameno' z. Ismet Gashi, që e ka sqaruar shumë qartë gjendjen aktuale në arsim dhe në shkollën e tij, atje janë nga 38 nxënës në një paralele, ka

rritje të madhe të numrit të nxënësve, kriteret legale për regjistrimin e nxënësve në shkollë me kontratë të banesës, ai atje nuk është një drejtor 'ad hoc', i njeh proceset me vite dhe mundohet maksimalisht të gjenë zgjidhjet më të mira në rrethanat që i ka. Ne kemi shumë punëtorë të Karitasit që i marrin pagat dhe rrinë në shtëpi, por në shëndetësi dhe arsim, ka punëtorë shumë të mirë që japin një kontribut të jashtëzakonshëm në punë. Të ndëruarë kolegë, ju po e shihni propozimin në fjalë, ne duhet ta ofrojmë një zgjidhje të arsyeshme për momentin, që nuk është në harmoni të plotë me ligjin, për është e nevojshme për fillimin e mbarë të procesit arsimorë, në prag të vitit të ri shkollorë 2021/2022 dhe këtu të gjithë duhet të jemi unanim, sepse kemi të bëjmë me fëmijët tanë me nxënësit, ata nuk kanë fajë për gjendjen e krijuar në disa vite me radhë.

Mehdi Lahu: Mua kolegë po më befason me sqarimet e tij Nënkrjetari i Komunës, normat ndahen për kokë të banorëve, ato norma janë humbur me arsyetime të ndryshme, shpeshëherë edhe të pa arsyeshme, tani duhet ta gjejmë një zgjidhje konkrete dhe në këtë proces pajtohemi, se duhet të jemi dakort të gjithë njëzëri.

Nënkrjetari i Komunës: Norma e nxënësve për një klasë në nivel të Kosovës është 12-13 nxënës, ndërsa në Komunën e Fushë-Kosovës është 23 nxënës për një klasë, ndërsa janë edhe katër mijë vende të lira të punës dhe nuk kemi një reflektim nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Arsimit.

Mehdi Lahu: Drejtoria e Arsimit këtu e ka ofruar një zgjidhje të përkohshme, sepse jemi të informuar se janë shumë paralele në klasën e parë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Vjet kanë qenë pesëmbëdhjetë paralele në klasën e parë, ndërsa në këtë vit shkollorë 2021/2022, tani janë tetëmbëdhjetë paralele vetëm në klasën e parë në shkollën 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë.

Aida Alimi: Në parim ne jemi që të përkrahet arsimi, por ju me mos menaxhim si duhet në një kohë më të gjatë e keni krijuar një kaos, është e vërtetë se edhe niveli qendrorë nuk e ka trajtuar Komunën e Fushë-Kosovës sipas specifikave që i ka, por njësoi me komunat tjera ku numri i nxënësve është në rënie. Ne e kemi një dendësi të madhe të banorëve, në lagjen ku graviton rruga 'Dardania' dhe disa rrugë tjera, kemi rritje enorme të numrit të nxënësve, andaj e përkrahim propozimin në fjalë, sepse për nxënësit duhet të gjejmë zgjidhje.

Sabit Bullatovci: Është kënaqësi të kemi shumë fëmijë, ju lutem mos vajtoni, në vitin 1976 në fshatin Miradi e Pöshtme, i kemi patur edhe katër nxënës serbë në shkollë, është mirë që arsimi është zhvilluar, jemi njëzet e një vite të lirë, ne tani e kemi shtetin tonë, e kemi Qeverinë tonë, e cila është e thirrur të gjejë zgjidhje për këtë probleme, ju e dini si ka qenë Fushë-Kosova në vitin 1999-2000, ka patur një trend të zhvillimit progresiv, janë krijuar lagje të reja, kanë ardhur banorë të ri, ne i kemi tridhjetë e katër mijë banorë zyrtarisht, ndërsa në realitet ofrojmë shërbime publike, administrative, arsimore dhe shëndetësore për gjashtë dhjetë mijë banorë, andaj unë e përkrah për zgjidhje këtë propozim për rritjen e normave në arsim dhe kërkoi që të jemi të ndërgjegjshëm në këtë çështje të gjithë së bashku.

Durim Hajra: Ju këtu keni propozuar që të kemi edhe psikolog, në kohën kur kërkojmë norma të reja për mësues të ri klasorë, sepse tani i kemi tetëmbëdhjetë paralele vetëm në klasën e parë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Sqaroi rekomandimin e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa dhe e qiti në votim 'Propozimin për rritjen e normave në arsim', përmes të cilit, kërkohet që t'i drejtohem Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, me një kërkesë zyrtare, për rritjen e tridhjetë normave të reja për mësimdhënës dhe dhjetë normave të reja për parashkollorë, si dhe marrjen e vendimit për hapjen e procedurës së prokurimit publikë për lidhjen e 'Marrëveshjeve të veçanta' për pranimin e punëtorëve arsimorë dhe stafit mbështetës, për gjashtë muaj me mundësi vazhdimi

edhe për gjashtë muaj tjerë, si dhe autorizimin e Kryetarit të Komunës, përmes delegimit të kompetencës për lidhjen e 'Marrëveshjeve të përkohshme të veçanta', për muajin shtator dhe tetor me qëllim të fillimit të mbarë të vitit shkollorë 2021/2022.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave, aprovon 'Propozimin për rritjen e normave në arsim' dhe i bënë këtë:

Kërkesë

Ministresë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministresë së Financave Punës dhe Transfereve, për rritjen e tridhjetë normave të reja për mësimdhënës dhe dhjetë normave të reja për parashkollorë në Komunën e Fushë-Kosovës.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovon 'Propozimin për hapjen e procedurës së prokurimit publikë për lidhjen e 'Marrëveshjeve të veçanta' për pranimin e punëtorëve arsimorë dhe stafit mbështetës, për gjashtë muaj me mundësi vazhdimi edhe për gjashtë muaj tjerë, si dhe autorizimin e Kryetarit të Komunës, përmes delegimit të kompetencës për lidhjen e 'Marrëveshjeve të përkohshme të veçanta', për muajin shtator dhe tetor me qëllim të fillimit të mbarë të vitit shkollorë 2021/2022 dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e propozimit Nr. 866, të datës 26.07.2021 dhe plotësimin e propozimit Nr. 899, të datës 02.08.2021 dhe lejinin e mjeteve financiare në shumë prej: 73,468.80€, për hapjen e procedurës së prokurimit publik për lidhjen e marrëveshjeve të veçanta, në kohëzgjatje prej gjashtë muajve me mundësi vazhdimi edhe për gjashtë muaj, për punëtorë në arsimin e Komunës së Fushë-Kosovës për Shkollën Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë dhe Shkollën Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Apollonisë.
2. Shpërndarja e këtyre normave në arsim sipas shpalljes publike vlenë për shkollën 'Mihal Grameno', shkollën në lagjen e Dardanisë dhe shkollën në lagjen e Apollonisë për punëtorë si vijon: drejtor dy, zëvendësdrejtor një, sekretar dy, psikolog tre, mësimdhënës klasor pesëmbëdhjetë, punëtorë teknik tetë, punëtorë për ngrohje qendrore një dhe roje një.
3. Kuvendi i Komunës e delegon kompetencën dhe e autorizon Kryetarin e Komunës, që të nënshkruan 'Marrëveshje të përkohshme të veçanta', për muajin shtator dhe tetor të vitit 2021, për fillimin e mbarë të procesit edukativo-arsimorë në vitin shkollorë 2021/2022.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për dhënien në shfrytëzim të automjetit zyrtar për Statcionin e Policisë në Fushë-Kosovë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për dhënien në shfrytëzim të automjetit zyrtar për Statcionin e Policisë në Fushë-Kosovë', për periudhën njëvjeçare. Hap diskutimin.

Migjen Kolshi: Kur e kam parë këtë kërkesë më është dukur si e pa besueshme dhe kam qesh, sepse Policia e Kosovës ka mjaftueshëm automjete në qarkullim për punën e saj, mendoj se është më mirë ta ketë policia, nëse e përdorë për punë në interesin e qytetarëve, nëse nuk keqpërdoret edhe nga ata, sikur veprojnë edhe menaxhmenti i komunës dhe disa zyrtarë komunal që dihen dhe i përdorin automjeteve zyrtare jashtë orarit të punës.

Sabit Bullatovci: Policia e Kosovës ka mjaftë automjete të saj, unë i kam lajmëruar se po thyhet salla e sporteve dhe po qarkullojnë persona të rinjë, që po përdorin edhe substanca narkotike, më

kanë thënë ri more flejë. Në të kaluarën, por edhe tani patrollojnë më rrallë edhe KFOR-i, të cilët i falënderojmë për kontributin e tyre në sigurinë e përgjithshme. Policia e Kosovës ka automjete sa të duash, por nuk janë në nivelin e detyrës së tyre, e njëjta vlenë edhe për Inspektorët e Komunës, të cilët duhet të jenë më azhur në punën e tyre, për t'i eliminuar dukuritë negative në shoqërinë tonë.

Durim Hajra: Kjo kërkesë për dhënien në shfrytëzim të një automjeti zyrtarë Statcionit të Policisë në Fushë-Kosovë, nuk është e arsyeshme fare, duhet të jeni më serioz, nuk ka nevojë të mirremi më këtë çështje, ata kanë mjaftë automjete.

Ali Ismaili: Kjo pikë e rendit të ditës, po më duket si rubrika 'Hajt pak' e televizionit Koha, aspak serioze, ne automjetet tona i kemi blerë me mjete të taksapaguesve, por ne i kemi dhënë automjete zyrtare edhe Organizatave Jo Qeveritare si është Karitasi në përdorim.

Driton Ademi: Unë po besoi se Policia e Kosovës i ka shterrur kërkesat e saj, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pastaj ka ardhur me kërkesën e saj në komunë, nëse është në funksion të rritjes së sigurisë publike ne pajtohemi, tani e kemi një situatë të vështirë edhe më zjarret në teren, jemi edhe në kohën e pandemisë dhe ky automjetë zyrtarë, po jipet vetëm në shfrytëzim të përkohshëm.

Nënkryetari i Komunës: Kjo kërkesë ka rrjedhë pas një takimi me Komandantin e Statcionit të Policisë në Komunën e Fushë-Kosovës, meqë jemi edhe në kohën e pandemisë, policisë i nevojitet kjo makinë për lëvizje në qytetin tonë, për vëzhgim të situatës në përgjithësi, andaj e kemi këtë 'Propozim për dhënien në shfrytëzim të kësaj makine për periudhën një vjeçare'.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për dhënien në shfrytëzim të automjetit zyrtar për Statcionin e Policisë në Fushë-Kosovë', për periudhën një vjeçare me mundësi vazhdimi.

U votua me: dhjetë vota 'për' asnjë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej dhjetë anëtarë që votojnë, andaj Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se në mungesë të pjesëmarrjes në votim propozimi nuk kalon.

Pika e shtatë (7) - Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Durim Hajra: Tani është mirë që në sallën e Kuvendit të Komunës, është vendosur fotografia e Komandantit Legjendarë Adem Jashari.


Nënkryetari i Komunës: Edhe ne pajtohemi me vendosjen e fotografisë së Komandantit Legjendarë Adem Jashari, i cili është ndër figurat më të ndritura të popullit tonë, në luftën për liri dhe çlirim, por vendosja e saj është bërë pa leje.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Këtë punë është dashur ta bëni në fillim të mandatit zgjedhor, e jo në prag të fushatës zgjedhore në fund të mandatit. Komandanti Legjendarë Adem Jashari është i të gjithëve dhe ne pajtohemi me vendosjen e fotografisë së tij, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.
Mbledhja përfundoi në ora 13:25 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

